



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,  
mbajtur më 13.3.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Trierë Kasumi-Berisha (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Feim Osmani (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Fikneta Bejtë (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Granit Geci (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Agim Kuleta (LB), Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Petrit Reçica (LVV), Berat Lahu (LVV), Berna Sarac (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Ermal Osmani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Amir Simnica (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Sami Salihu (LDK), Gresa Lahu (PDK), Agron Canolli (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Gëzim Mehmeti (AKR).

Të pranishëm ishin edhe: Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Donikë Çetta, drejtore e Drejtorisë së Parqeve, Donjeta Dragusha, drejtore e Drejtorisë së Bujqësisë, Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Sibel Halimi, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Alban Zogaj, nënkyrytar i Komunës, Georg Schnetzer, ambasador i Austrisë në Kosovë, Arben Hajrullahu, rektor i Universitetit, Arsim Vranovci, president i Shoqatës së Miqësisë Kosovë-Austri, përfaqësues të OSBE-së dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, me këtë

Rend dite:

1. Propozim-vendimi për emërtimin e sheshit "Dr. Erhad Busek".

**Kryesuesi** fillimisht i përshëndeti të pranishmit, në veçanti ambasadorin e Austrisë në Kosovë, z. Georg Schnetzer, rektorin e Universitetit të Prishtinës, z. Arben Hajrullahu, z. Arsim Vranovci, president i Shoqatës së Miqësisë Kosovë - Austri, z. Andreas Fritz, nënkyetar i shoqatës, si dhe përfaqësuesit tjerë të shoqatës dhe të pranishmit tjerë pjesëmarrës në këtë mbledhje.

**Përparim Rama**, kryetar, tha se është kënaqësi e veçantë me qenë sot këtu së bashku me gjithë ju të nderuar asamblistë, me z. Georg Schnetzer, ambasador, z. Arben Hajrullahu, rektor i Universitetit, z. Arsim Vranovci president i Shoqatës së Miqësisë Kosovë - Austri.

Sot do të vendosim që sheshi përballë bibliotekës kombëtare "Pjetër Bogdani", të emërtohet me emrin e një miku të madh të Kosovës, dr. Erhard Busek. Historia jonë me Austrinë është më shumë sesa histori e aleancave politike, është histori e besëlidhjes, e ndihmës së përbashkët, madje mund ta qujmë edhe histori e vëllezërisë në mes dy popujve tanë. Dr. Erhard Busek ishte ai që e rriti edhe më shumë këtë vëllezërim mes popujve tanë. Më shumë se politikan, ai ishte vizionar, sepse e pa Kosovën jo si problem, por si shpresë.

Sot po e emërtojmë këtë shesh me krenari. Le ta quajmë sheshi "Dr. Erhard Busek", jo thjesht për të nderuar njeriun, por për ta kurorëzuar këtë miqësi që kapërcen kufijtë e Kosovës.

**Gëzim Sveçla** tha se raportet e mira mes Kosovës dhe Austrisë datojnë prej kohërave shumë të vjetra, do të thotë nuk është e dekadës, nuk është as e këtij shekulli, mirëpo Austria për shekuj të tërë ka qenë një përkrahëse e madhe e shqiptarëve në përgjithësi. Ky bashkëpunim në aspektin e dy popujve, është i mbështetur në vlerat evropiane, në vlerat e solidaritetit dhe humanizmit me njëritjetrin, dhe në përpjekjet e përditshme për liri dhe për vetëvendosje si koncept. Një prej atyre personaliteteve që ka bërë ndikim të jashtëzakonshëm në thellimin e kësaj miqësie, pa dyshim është dr. Erhard Busek, interesimi dhe angazhimi i të cilit për Kosovën dhe për shqiptarët daton qysh nga vitet e 80-ta, do të thotë vizita e parë e tij në Kosovë ishte në vitin 1987.

Ne e përkrahim dhe e mbështesim propozimin për emërtimin e këtij sheshi.

**Ajet Brajshori** tha se sot jemi tubuar në një datë të veçantë për të emërtuar sheshin me emrin e të madhit Erhard Busek, i cili vërtetë ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për Kosovën. Ai ishte një dijetar i madh, një diplomat i madh, një politikan i madh dhe, në veçanti një njeri me shpirt të madh për të drejtat e njerëzve kudo që janë, e në veçanti për Kosovën. Ai ishte personi i parë i cili mundësoi pranimin e studentëve në universitetet e Austrisë, atëherë kur universitetet tona u mbyllën nga okupatori serb. Është një nder shumë i madh për neve, ndoshta është shumë i vogël për të madhin Erhard, por simbolika e tij do të fuqizojë edhe më shumë bashkëpunimin dhe mirësinë e përhershme me shtetin e Austrisë, andaj ne, grupi i LDK-së, me kënaqësi, me nderë dhe respekt të përhershëm e përkrahim propozimin që ky shesh të emërtohet me emrin Erhard Busek.

**Leutrim Retkoceri** tha se sot është një ditë e rëndësishme për neve si kryeqytet, kur mund të ndajmë diçka nga pjesa jonë e hapësirës së kryeqytetit, për të nderuar miq siç ishte Erhard Busek, një person i dëshmuar në politikën e vendit të tij, Austrisë, dhe një person që ka vazhduar të rrisë një miqësi të kohërave të vjetra mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Austrisë. Shpresoj që ky bashkëpunim të jetë i ngrohtë, i afërt dhe i kultivuar edhe në të ardhmen.

Përveç këtij propozimi të qëlluar, kemi parë se është edhe propozimi për një rrugë në emër të rektorit të nderuar, tashmë të ndjerit dr. Ejup Statovci. Unë pres nga kryetari i Komunës dhe propozuesit, që sa më parë të dalim edhe me propozimin për ish-rektorin e nderuar, z. Ejup Statovci.

Vota e PDK-së në këtë Kuvend do të jetë për emërtimin e sheshit "Dr. Erhard Busek".

**Bahri Gashi** theksoi se, sot po e japim respektin tonë si komb dhe si kryeqytet, dhe besoj që është shumë e qëlluar, sepse pa miqtë tanë, në mesin e tyre edhe i nderuari Erhard Busek, nuk do të mund të ecnim më tej. I falënderojmë të gjithë dhe do të përpinqemi çdoherë që me këto falënderime t'i përkujtojmë të gjithë ata që na kanë përkrahur.

Grupi ynë e përkrah këtë vendim për miratim.

**Sami Borovci** u shpreh se, lokacioni i propozuar për emërtimin e këtij sheshi është më se i qëlluar, duke pasur parasysh edhe rolin e dr. Erhard Busek, në ndihmën që i dha Kosovës dhe edukimit të të rinjve, ose shkollimit të studentëve tanë në Austri. Ne jemi për dhe me kënaqësinë më të madhe e votojmë këtë propozim-vendim.

**Endrit Zabërgja** theksoi se, kam kënaqësinë që sot në këtë seancë solemne, t'i bashkëngjitim pozitivisht propozimit të kryetarit Rama për emërtimin e sheshit "Erhard Busek", një personalitet i dëshmuar dhe i veçantë në ndihmë të kauzës sonë, e në veçanti të përkrahjes së studentëve tanë për shkollim në Austri, duke shprehur mirënjojen e thellë për popullin austriak dhe për veprat e tyre, sidomos për konsolidimin e themelimin e shtetit të parë shqiptar e deri më tani.

Ne shprehim mirënjojen tonë duke përkrahur miratimin e kësaj pike për emërtimin e këtij sheshi.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 34 vota për, u miratua Vendimi për emërtimin e sheshit "Dr. Erhad Busek".**

**Georg Schnetzer**, ambasador i Austrisë në Kosovë, me një fjalim rasti i falënderoi të gjithë të pranishmit për emërtimin e këtij sheshi me emrin e bashkëkombësit të tij, dr. Erhad Busek.

*Mbledhja përfundoi në orën 10.45.*

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

